



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 01, datë 08.01.2016

PËR

VAZHDIMIN E PROCEDURAVE NGA AGJENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT
PËR LËSHIMIN E DOKUMENTIT TË LEJES SË NDËRTIMIT, BAZUAR NË LEJET
ZHVILLIMORE KOMPLEKSE TË MIRATUARA NË KKT PËRPARA HYRJES NË FUQI
TË LIGJIT NR. 107/2014 “PËR PLANIFIKIMIN DHE ZHVILLIMIN E TERRITORIT”, I
NDRYSHUAR

Në mbështetje të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, e ndryshuar, si dhe Vendimit Nr. 1097, datë 28.12.2015 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, me propozimin e Ministrisë së Zhvillimit Urban, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Agjencia e Zhvillimit të Territorit të ndjekë procedurat për lëshimin e Dokumentit të Lejes së Ndërtimit, për Lejet Zhvillimore Komplekse të miratuara nga Këshilli Kombëtar i Territorit përpara hyrjes në fuqi të Ligjit Nr. 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, gjatë periudhës së vitit 2014 sipas legjislacionit në fuqi.
2. Dokumenti i Lejes së Ndërtimit i jepet subjektit kërkues vetëm pas:
 - a) plotësimit të gjithë dokumentacionit ligjor dhe teknik, sikurse evidentuar nga sekretariati i KKT-së në momentin e miratimit të lejes;
 - b) pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë, për llogari të Njesisë së Qeverisjes Vendore.
3. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

EDI RAMA



ZËVENDËS KRYETAR I KKT

EGLANTINA GJERMENI

MINISTËR I ZHVILLIMIT URBAN



SEKRETAR I KKT

LEDIA TOTA



DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

SAIMIR TAHIRI
ANËTAR I KKT




EDMOND HAXHINASTO
ANËTAR I KKT




ARBEN AHMETAJ
ANËTAR I KKT




YLLI MANJANI
ANËTAR I KKT

MIRELA KUMBARO
ANËTAR I KKT




DAMIAN GJIKNURI
ANËTAR I KKT




EDMOND PANARITI
ANËTAR I KKT




LEFTER KOKA
ANËTAR I KKT



GJON RADOVANI
ANËTAR I KKT